

Janë duke bërë xhiron e botës pamjet e një fëmije që ikën i tmerruar nga shtëpia e shkatërruar prej bombave të hedhura nga aeroplanët rus në zonën e provincës Hama në Siri.

Daily Mail raporton se aeroplanët rus në përkrahje të diktatorit sirian Bashar Al-Assad bombarduan me bomba-parashutë zonat e mbajtura nga rebelët në Hama duke shkaktuar dëm të konsiderueshme edhe në civilë, përcjell Albeu.com.

Në video dëgjohet një burrë që filmon momentin e hedhjes së bombave si edhe tmerrin e fëmijëve duke u larguar nga zona e bombarduar.

Bombat parashutë përdoren kryesisht kundër tuneleve të rebelëve pasi konsiderohen si më precize krahasuar me të tjerat. Rusia po i përdor ato prej dy vitesh gjatë ndihmës që po i jep Assadit kundër rebelëve.